

GJYKATA E QARKUT - PRISHTINË/PRIŠTINA
P Nr. 504/2010
4 Korrik 2011

NË EMËR TË POPULLIT

Trupi Gjykses i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, i përbërë nga Gjykatësja e EULEX-it Karen Asphaug, Kryetare e Trupit Gjykses, dhe Gjykatësi i EULEX-it Ferdinando Buatier de Mongeot dhe Gjykatësja Kosovare Fellanza Kadiu, si anëtarë të Trupit Gjykses, të ndihmuar nga procesverbal mbajtësja Svetoslava Savova, në çështjen penale kundër të të pandehurve:

X. T., , Shqiptarë i Kosovës, në paraburgim që nga 27 Maji 2010,

A. K., , Shqiptarë i Kosovës; në paraburgim që nga 2010,

G. I., , Republika e Shqipërisë, shtetas i Shqipërisë, në paraburgim që nga 4 Dhjetori 2010,

Të akuzuar me aktakuzën e ngritur në Gjykatë më 23 Dhjetor 2010, nga ana e Prokurorit të EULEX-it i Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës (PSRK), Maarit Loimukoski, për veprat si në vijim:

Akuza 1: Blerja, Posedimi Shpërndarja dhe Shitja e Paautorizuar e Narkotikëve të Rrezikshëm dhe e Substancave Psikotropike, në pajtim me Nenin 229, Paragrafët 1, 2, 3, dhe 4 të Kodit Penal të Kosovës (KPK) e lidhur me Nenin 23 dhe kjo e denueshme prej tri deri më pesëmbëdhjetë vjet burgim; vepër që pretendohet se ka ndodhur në mes të 24 Korrikut 2009 dhe 15 Shtatorit 2009 nga ana e A. K. t dhe X. T. .

Akza 2: Blerja, Posedimi Shpërndarja dhe Shitja e Paautorizuar e Narkotikëve të Rrezikshëm dhe e Substancave Psikotropike, në pajtim me Nenin 229, Paragrafët 1, 2, 3, dhe 4 të Kodit Penal të Kosovës (KPK) e lidhur me Nenin 23 dhe kjo e denueshme prej tri deri më pesëmbëdhjetë vjet burgim; vepër që pretendohet se ka ndodhur në mes të 4 Shtatorit 2009 dhe 6 Shtatorit 2009 nga ana e G. I. ;

Count 3: Blerja, Posedimi Shpërndarja dhe Shitja e Paautorizuar e Narkotikëve të Rrezikshëm dhe e Substancave Psikotropike, në pajtim me Nenin 229, Paragrafët 1, 2, 3, dhe 4 të Kodit Penal të Kosovës (KPK) e lidhur me Nenin 23 dhe kjo e denueshme prej tri deri më pesëmbëdhjetë vjet burgim; vepër që pretendohet se ka ndodhur në mes të 1 Tetorit 2009 dhe 25 Nëntorit 2009 nga ana e X. T. ;

Count 4: Krimi i Organizuar, në pajtim me Nenin 274, të KPK dhe i dënueshëm prej shtatë deri në njëzet vjet burgim, vepër që pretendohet se ka ndodhur në mes të 24 Korrikut 2009 dhe 20 Majit 2010 nga ana e A. K. t dhe X. T. ; dhe

Count 5: Krimi i Organizuar, në pajtim me Nenin 274, të KPK dhe i dënueshëm prej shtatë deri në njëzet vjet burgim, vepër që pretendohet se ka ndodhur në mes të 4 Shtatorit 2009 dhe 6 Shtatorit 2009 nga ana e G. I. t;

Pas seancave të hapura për publikun të shqyrtimit kryesor të mbajtura më 28, 29, 30 Mars, 26, 27, 28 Prill, 6, 14, 15, 28, 29 Qershor 2011, në prani të të akuzuarve, avokatëve të tyre mbrojtës (Visar Vehapi në emër të A. K. t; Bahtir Troshupa në emër të X. T.t; dhe Gafurr Elshani për G. I. n) dhe Prokurorit Publik (Maarit Loimuskoski),

Pas pleqërimit dhe votimit që është bërë më 30 Qershor dhe 1 Korrik 2011, në pajtim me nenin 390 paragrafi 3 dhe nenit 391 të KPPK, e lëshon këtë:

AKTGJYKIM

Akuza 1: A. K. dhe X. T. shpallen të pafajshë për kryerjen e veprës penale Blerja, Posedimi Shpërndarja dhe Shitja e Paautorizuar e Narkotikëve të Rrezikshëm në kundërshtim me nenin 229 paragrafi 1,2,3,4, i KPK,

Sepse nuk ka dëshmi të mjaftueshme për të provuar akuzën përtej dyshimit të arsyeshëm; në veqanti, nuk ka patur prova të mjaftueshme të natyrës dhe sasisë së drogave narkotike dhe substancave psikotropike që pretendohet se të Pandehurit i kanë poseduar dhe i kanë shpërndarë.

Akuza 2: G. I. shpallet i pafajshëm për kryerjen e veprës penale Blerja, Posedimi Shpërndarja dhe Shitja e Paautorizuar e Narkotikëve të Rrezikshëm në kundërshtim me nenin 229 paragrafi 1,2,3,4, i KPK,

Sepse nuk ka dëshmi të mjaftueshme për të provuar akuzën përtej dyshimit të arsyeshëm; në veqanti, nuk ka patur prova të mjaftueshme të natyrës dhe sasisë së drogave narkotike dhe substancave psikotropike që pretendohet se i Pandehuri i ka poseduar dhe i ka shpërndarë.

Count 3: X. T. shpallet fajtor për veprën penale Blerja, Posedimi Shpërndarja dhe Shitja e Paautorizuar e Narkotikëve të Rrezikshëm dhe e Substancave Psikotropike, në kundërshtim me nenin 229 paragrafi 2 dhe 4 të KPK e lidhur me Nenin 23 të të njejtit kod,

Sepse X. T. , në bashkëkryerje me të tjerët, përfshirë por jo i kufizuar me S. T., G. G., A. T. dhe H. T., e ka organizuar, mbikqyrur dhe drejtuar blerjen e substancave

narkotike, në veqanti 109 kilogramë të Cannabis sativa, dhe e ka planifikuar importin e të njejtës nga Shqipëria në Kosovë me tentim të shpërndarjes në vendet tjera të Evropës.

Akuza 4: X. T. shpallet fajtor për veprën penale krim i organizuar në kundërshtim me nenin 274 paragrafi 3 i KPK, dhe **A. K. shpallet fajtor** për veprën penale krim i organizuar në kundërshtim me nenin 274 paragrafi 2 i KPK,

Sepse në mes të 24 Korrikut 2009 dhe 30 Nëntorit 2009 X. T. dhe A. K. kanë marrë pjesë në mënyrë aktive dhe të strukturuar në grupin e krimit të organizuar të përbërë nga tre apo më shumë persona, qëllimi i të cilëve ishte që të transportojnë, dërgojë dhe shpërndajë droga narkotike me tentativë që ta shpërndajnë atë, ta shesin apo orfrojnë për shitje. X. T. e ka organizuar, mbikqyrur dhe e ka menaxhuar aktivitetin e grupit të krimit të organizuar duke e aranzhuar dhe koordinuar importin, ngarkimin dhe financimin e ngarkimit të substancave të kontrolluara. A. K. në mënyrë aktive ka marrë pjesë në grupin e organizuar kriminal duke, përveq aktiviteteve tjera, aranzhuar korrierët që ti transportojnë substancat e kontrolluara, duke e ditur se pjesëmarrja e tij do të ndihmonte në kryerjen e krimeve serioze nga ana e e grupit të organizuar kriminal.

Akuza 5: G. I. shpallet i pafajshëm për veprën penale krim i organizuar në kundërshtim me nenin 274 paragrafi 1 dhe 2 i KPK

Sepse nuk ka dëshmi të mjaftueshme për të provuar akuzën përtej dyshimit të arsyeshëm; në veqanti, nuk ka patur dëshmi të mjaftueshme se i Pandehuri ishte anëtarë i një grupi të organizuar kriminal apo se e ka ditur se ai ishte duke kontribuar për kryerjen e krimeve serioze kriminale nga ana e një grupi të organizuar kriminal.

DËNIMI

A. K. :

Akuza 4: Në pajtim me nenin 38 dhe 274 paragrafi 2 i KPK, **A. K.** dënohet me 8 vite burgim.

X. T. :

Akuza 3: Në pajtim me nenin 38 dhe 274 paragrafi 3 i KPK, **X. T.** dënohet me 7 vite burgim dhe me gjobë prej 200.000 Eurove,

Akuza 4: Në pajtim me nenin article 38 dhe 229 paragrafi 2 dhe 4 pika 1 i KPK, **X. T.** dënohet me 10 vite burgim.

Në pajtim me nenin 71 paragrafi 1 pika 1 i KPK, dënimi unik i ngarkuar ndaj X. T. është 15 vite burgim dhe gjobë 200.000 Euro.

Konfiskimi:

Në pajtim me nenin 490 (1) të KPPK, Gjykata konfiskon shumën prej 13.000 Eurove nga i pandehuri A. K. si fitim materail i siguruar nga kryerja e veprës penale apo si rezultat i së njejtës.

Gjykata nuk i konfiskon ndonjë mall të pandehurit X. T. , sepse Gjykatës i janë paraqitur dëshmi të pamjaftueshme që provojnë se prona e X. T. ka lidhje me veprimtaritë kriminale.

Shpenzimet e procedurës:

Të pandehurit, A. K. dhe X. T. , së bashku, do ti paguajnë shpenzimet e procedurës në shumë prej 300 Eurove.

Paraburgimi

Paraburgimi i të akuzuarit A. K. dhe X. T. me këtë caktohet deri në kohën kur ky aktgjykim të bëhet i plotfuqishëm.

G. I. lirohet menjëherë nga paraburgimi

Arsyetimi

Historiku i Procedurës

1. Më 23 Dhjetor 2010 Zyra e Prokurorisë Speciale e Republikës së Kosovës (PSRK) ka ngritur aktakuzën kundër A. K. t, X. T. dhe G. I. t.

2. Aktakuza i ka ngarkuar të pandehurit për Blerje, Posedim, Shpërndarje dhe Shitje e Paaautorizuar e Narkotikëve të Rrezikshëm dhe e Substancave Psikotropike, dhe Krim i Organizuar. Aktakuza pohon se A. K. dhe X. T. kanë organizuar dërgesën e drogave në Shtator të 2009, si dhe që X. T. e ka organizuar gjithashtu të ashtuquajturën dërgesa e Nëntorit. Gjithashtu pohoet se A. K. dhe X. T. ishin pjestarë të një grupi kriminal prej Korrikut 2009 deri në Maj të 2010. G. I. ngarkohet me vepra të njejta por korniza kohore kur ai pretendohet se i ka kryer këto vepra penale reduktohet për periudhën në mes të 4 dhe 6 Shtatorit 2009.

3. Seanca e konfirmimit ishte mbajtur para të Nderuarit Gjykatësit të EULEX-it në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë, Dr. Horst Proetel. Më 24 Janar 2011 Gjykatësi Proetel ka lëshuar vendimin për konfirmimin e aktakuzës në tërësin e sajë.

4. Çështja ka vazhduar me shqyrtimin kryesor dhe senacat gjyqësore janë mbajtur më 28, 29, 30 Mars 2011; 26, 27, 28 Prill 2011: 6, 14, 15, 29 Qershor 2011; dhe 1 Korrik 2011 para trupit gjykues më poshtë të nënshkruar.

5. Dëshmiat në vijim janë paraqitur dhe kanë dëshmuar në shqyrtimin kryesor: Valentina Gashi, Rreshteri Kadri Gashi; dhe oficeri Gezim Islami (dy dëshmitarët e fundit janë të punësuar nga Policia e Kosovës).

6. Përveq dëshmimeve të dëshmitarëve, trupi gjykues ka marrë provat si në vijim:

a. Materialet nga Republika e Shqipërisë

- Raportin policor mbi operacionet të datës 26, 28, 29, dhe 30 Shtator 2009;
- Raportin policor nga Shqipëria të 1, 2, 3 dhe 5 Tetor 2009;
- Raportin e oficerit të policisë lidhur me 25.11.2009;
- Raportin e oficerit të policisë lidhur me 26, 27, 28, 29 dhe 30.9.2009;
- Raportin e oficerit të policisë lidhur me 1, 2, 3 dhe 5.10.2009;
- Raportin e oficerit të policisë lidhur me 16 dhe 22.10.2009;
- Raportin e oficerit të policisë lidhur me 7, 8 dhe 9.10.2009;
- Procesverbalin e inspektimit të makinës Mercedes Benz me Targa TR 75981;
- Raportin e sendeve të konfiskuara nga ana e Policisë së Shqipërisë;
- Analizat e Ekspertëve të Forenzikës së Republikës së Shqipërisë të Substancave të gjetura pas konfiskimit;
- Raporti nga Republika e Shqipërisë lidhur me konfiskimin e kamionit (të S. T.) i datës 30.11.2010 (përfshirë fotografitë me shenjën "CD 5");

b. Materialet nga Kosova

- Raporti i Vëzhgimit të Policisë së Kosovës i datës 5.08.2009, 2 deri 5.09.2009 dhe 19.11.2009;
- Raporti i Vëzhgimit të Policisë së Kosovës i datës 3, 4, 5 Shtator 2009;
- Shtesa e Raportit të Vëzhgimit e datës 24.05.2010 me fotografi;

- Raporti i Policisë së Kosovës datë 3 Mars 2010: raporti i përgjimit mbi rezultatet dhe analizati –'përmbledhja e të dyshuarve';
- Raporti i Policisë së Kosovës datë 16 Qershor 2010 (Ref: 2008-XZ-039) re: hetimi financiar;
- Raporti i Policisë së Kosovës mbi Rezultatet e Hetimit Financiar datë 17 Dhjetor 2010;
- Raporti i Policisë së Kosovës për Kontrollimin e shtëpisë së X. T. datë 27.5.2010;
- Marrëveshja e borxhlinjëve, e konfiskuar gjatë kontrollimit të shtëpisë së X. T. më 27.5.2010;
- Raporti i Policisë së Kosovës për Kontrollimin e shtëpisë së A. K. datë 27.5.2010;
- Raporti Shtesë i Policisë së Kosovës datë 31.5.2010 (2008-XZ-039);
- Raport i ekzaminimit forensikë (Ref: 2008-XZ-039) të sendeve të gjetura gjatë kontrollimit të shtëpive të A. K. dhe X. T.T;
- Kosovo Customs report on G. I. dated 4th December 2010;
- Raporti i Policisë Doganore Regjionale të Kosovës për G. I. datë 4 Dhjetor 2010;
- Urdhëri nga ana e Oficeri i Lartë i Policisë Kadri Gashi për G. I. datë 30 Nëntor;
- Raport i Expertit mbi analizat forenzike të telefonit të G. I. ;
- Raporti i Policisë së Kosovës lidhur me transkriptin e përgjimit të CD-ve nga Shqipëria, 17.11.2009 – 25.11.2009, datë 01 Mars 2010;
- Deklaratat e A. K. , dhënë Prokurorit, datë 01 Qershor 2010 dhe 01 Dhjetor 2010;
- Deklaratat e X. T. dhënë Prokurorit, datë 02 Qershor 2010, 02 Dhjetor 2010 dhe 06 Dhjetor;
- Deklarata e G. I. dhënë Prokurorit, datë 09 Dhjetor 2010;

- Deklarata e Valentina GARA dhënë Prokurorit, datë 04 Qershor 2010;
- Deklarata e Bashkim GASHI dhënë Policisë, datë 10 Qershor 2010;
- Deklarata e Valter SHMID dhënë Policisë, datë 11 Qershor 2010;
- Të gjitha transkriptet në Dosjen Kryesore të Përgjimeve (bashkangjittur edhe CD e përgjime);
- Të gjitha transkriptet në Dosjen e Përgjimeve I, II, III, IV, V, VI, VII, VIII, IX dhe X që kanë të bëjnë me X. T., A. K. dhe G. I. ;

c. Materialet nga Sllovenia

- Aktgjykimi i shkallës së parë të Gjykatës së Qarkut të Kranjit, Slloveni;
- Aktgjykimi i shkallës së dytë të Gjykatës së Qarkut të Kranjit, Slloveni;
- Aktgjykimi i shkallës së parë së Gjykatës së Qarkut të Ljubljanës, Slloveni;
- Përgjimet që kanë të bëjnë me A. K. (të përkthyer) të inçizuar nga ana e Policisë Sllovene;
- Raporti mbi konfiskimin e drogave në makinën e Adrian CANA (përfshirë fotografitë me shenjën "CD4");

d. Materiali nga Gjermania

- Raporti financiar i marë nga autoritet Gjermane që i përketë X. T.t;

e. Materialet nga Interpolli

- Urdhër arrest për A. K. nga Sllovenia; dhe
- Urdhër arrest për A. K. nga Italia

Gjetja e Fakteve dhe Vlerësimi i Dëshmime

Më 18 Shtator 2008, Zyra Ndërlidhëse e Interpollit në Prishtinë ka marë një kërkesë me shkrim për bashkëpunimin dhe hetimin e përbashkët nga ana e Zyrës së Interpollit

në Ljublanë, Slloveni lidhur me personat e dyshuar të përfshirë në krim të organizuar dhe në trafikim të drogës. Në përgjegje të kësaj kërkesë, në Kosovë është inicuar një hetim. Hetimi është zhvilluar kryesisht me mjete të përgjimit ligjor të komunikimeve dhe me vështrimin e fshehtë.

Të pandehurit X. T. dhe A. K. dëshmohej të jenë anëtarë të një grupi të organizuar kriminal me seli në Shqipëri që ka futur droga ilegale përmes Shqipërisë në Kosovë, dhe më pas në destinacionet tjera të Evropës, përfshirë Slloveninë, Holandën dhe Italinë. Grupi dhe aktiviteti i tyre filloi të hetohet si pasojë e një arrestimi në Slloveni. I pandehuri G. I. dyshohet se ka qenë korier për një nga dërgesat e drogës.

X. T. është banor i fshatit Caprac afër Prizrenit. Ai ishte pronar i supozuar i Restoranit Dora që gjendet në Prizren. z.T. ka banesë në Caprac dhe në Prishtinë. Ai vozitë makina luksoze, përfshirë këtu një Mercedes Benz. Më herët ai kishte në pronësinë e tij një makinë Audi. z.T. është i martuar dhe ka patur një lidhje jashtë-martesore. Ish e dashura e tij ka dëshmuar se gjatë kohës që ishin bashkë, ajo kishte marrë nga z.T. 5.000 deri 6.000 Euro. Sipas Rreshterit Kadri Gashi, drejtues i hetimeve në këtë çështje, Restorani Dora nuk ka gjeneruar punë të mjaftueshme për të qenë biznes i suksesshëm. Biznesi ndërmarrës legjitim i z.T. nuk ka mund ta mbështes mënyrën e jetesës që ai qonte. Gjatë kohës së shqyrtimit kryesor z.T. tha se ai është në farefisni me A. K. .

A. K. është banor i fshatit Korish afër Prizrenit. Në kohën e mbajtjes së shqyrtimit kryesor ai ka deklaruar se ai dhe X. T. janë shokë. Z.K. tha se është i varfër dhe se nuk ka të ardhura të rregullta.

G. I. pretendohet se është korier për dërgesën e drogave më 4 dhe 5 Shtator 2009. z.I. është banor i fshatit Koderlum, Komuna e Shtimes në Republikën e Shqipërisë.

Pjesëmarrësit kryesor të grupit të organizuar kriminal janë Xhemë T. , S. T. dhe G. G. (që të dy banor të Shqipërisë), dhe H. T. dhe A. T. (që të dy banor të Holandës). Hetimi i kësaj çështje është fokusuar në dy ngjarjet kryesore, në të ashtuquajturën 'Dërgesa e Shtatorit' dhe në të ashtuquajturën 'Dërgesa e Nëntorit'.

Përgjimi i komunikimeve telefonike ka ndodhur gjatë periudhës relevante kohore nga Korriku i 2009 e deri në Nëntor të 2009. Të pandehurit kanë komunikuar me mënyra të gjuhës së koduar, duke u përpjekur për të iu shmangur përdorimit të terminologjisë që ka të bëjë me drogën, dhe si zvendësim ju janë referuar substancave të kontrolluara duke përdorur terma tjerë, siç 'vetura', 'makina' ose të ngjashme. Të pandehurit dhe të tjerët në grupin e tyre kriminal gjithashtu kanë përdorur gjuhën e koduar për të iu referuar korierit.

Vështrimi i bërë gjatë hetimit ka nxjerë në dritë se takimet janë bërë në mes të X. T., S. T. , dhe G. G. në Vermice, Shqipëri.

Komunikimet e përgjuara në mes të X. T., S. T., A. K., H. T., G. G., G. I. dhe të tjerëve dëshmojnë për ekzistimin e një grupi kriminal ndërkombëtarë mirë të organizuar qëllimi i të cilit është të importojë dhe të shpërndajë substancat e kontrolluara me një përfitim të dukshëm për anëtarët e grupit. Thirrjet e përgjuara telefonike janë përplotë me referime në aranzhime financiare, në përfitime dhe në dërgesa të drogave. Edhe pse anëtarët e grupit flasin me kode duke u përpjekur ta mshëfin natyrën e vërtetë të tregëtimit të tyre, është e qartë nga tërësia e komunikimeve të përgjuara se ata flasin për një gjë, dhe vetëm për një gjë: krim i organizuar i fokusuar në importimin dhe shpërndarjes e narkotikëve ilegal.

Komunikimet e përgjuara nga faza e planifikimit për të ashtuquajturën dërgesa e Shtatorit përfshihen si në vijim:

- **27.7.2009 në orën 14:42:58**

X. T. flet me G. G. lidhur takimin e rradhës me S. T.. X. thotë se diçka ka shkuar keq "...E thirra ate një ditë dhe ai tha do të shoh, do të të sjelli diçka, ai do të duhej të sillte diçka e mos të lë luaj me mua, të shohim se çfarë do të sjellin ata sepse kjo punë ka shkuar keq..."

- **28.7.2009 në orën 21:58:26**

S. T. flet me A. T. nga telefoni i X. T.

"A. ti duhet të ndreqësh (rregullosh) me X. dhe me H. dhe G. në mënyrë që unë ta përfundojë punën brenda tri ditëve përndryshe unë e kam një makinë, unë do ta shes makinën dhe do ta paguaj borxhin tënd. Ti jetoje jetën tënde ; unë do ta jetojë timen so I can finish the job in three days otherwise I have the car, I will sell the car and pay back your debt. You get on with life; I will get on with mine..."

A.: "...ngadale daja Sylë, sepse unë do ta thërras ate, do të të thërras brenda pesë sekondave. Do të të thërras menjherë."

S.: "Ti duhet ta rregullosh këtë vetë sepse nuk dua që të përzihem në punët tuja, të shiqoje punën tënde e unë do ta shiqojë punën time..."

- **28.7.2009 në orën 22:07:38**

A. T. dhe X. T. flasin për borxhin që ata ia kanë S..

X.: "Është dashtë që ti them ta ç*** makinën, ti nuk mund të shesisish asgjë. Sa para i ke ti? Sa para i ke ti në total, sa i kemi borxh atij?"

A.: "Sa para ia ka dhënë Gezim atij? Sa ia kemi borxh? Ti bëje llogarinë."

X.: "Ai ka marë 18 në total."

- **28.7.2009 në orën 22:10:35**

A. dhe X. e vzhdojnë bisedën

A. : “Unë e pyeta se kush të ka premtuar dhe ai tha se H. i ka premtuar G. dhe unë shkova me ta te H. dhe e pyeta ku janë paratë e dajës Sylë? Ai tha ‘Cilat para?’ Unë i thashë paratë që ia ke premtuar atij, e gjitha që ne mund të bëjmë është që së paku tëia dërgojmë atij paratë. Nëse i meriton jepja ato, përse nuk po ia jep paratë atij? Unë i thashë se ti nuk ke nevojë të merresh me këtë. Unë do të merrem me dajën Sylë; a nuk të kam thënë që mos ti premtosh gjëra njerëzve?”

A.: “...të gjitha së bashkua, por ti e di se ata duhet të blejnë edhe për ty gjithashtu, sepse mua më duhet të gjithat për ty... Tani o njeri, ti i ke marë më shumë se gjysmën e parave...”

X. : “Ma jep të flas me G. që ta shoh nëse gjërat mund të rregullohen.”

• **3.8.2009 në orën 19:25:27**
Biseda në mes të X. dhe A. K.

X. : “Mirë, i thuaj atij që brenda një jave do ti gjejë nja 50.000 euro dhe do të meremi vesh.”

• **5.8.2011 në orën 12:37:32**
X. flet me G. G.

G. : “Hej ndëgjo, thirre Hamdiun meqë Goni më tha se H. do ti dërgojë paratë tek ti për të ia dhënë dajës Sylë.

X. : “Kë duhet ta thërras?”

G. : “H. . I thuaj a je duke i dërguar paratë me Western Union?”

X. : “Mirë, u krye.”

• **5.8.2009 në orën 16:07:35**
X. flet me A. T.

X. : “Jam me dajën Sylë dhe me G. , duke shkuar prap në shtëpinë tënde meqë duhet të shohim edhe për diçka tjetër gjithashtu.”

A. : “Mirë, shiqo që ai të flas me një shok të tij nëse mund të ia marë/borxh nja 4500 euro e ti sjell këtu.”

X. : “a është ai në gjendje ta bëjë këtë?”

A. : “Po, atje, dhe unë do të jem baraz me ta.”

X.: "U kry, a ti them Zenelit mos ti merë hiq biletat?"

A. : "Mirë, thuaji. I thua atij të voglit, ai do ta gjejë një shok dhe do ta kryen punën dhe pastaj unë ia jap të voglit. Dhe jepja 4500 euro dhe ai do të më thërras në telefon dhe nuk do të na mërzis më."

X.: "Meqë jemi këtu bashkë, duke shkuar në fshat. Ku do ja japish, në Shqipëri?"

A.: "Jo, këtu në Kosovë... 4500 euro, po them se unë do ia japi atij këtu dhe ai do ti japi ty atje."

- **7.8.2009 në orën 14:47:57**

X. flet me motrën e tij Katrina lidhur me deponimin e një sasive të madhe të parave të gatshme në xhirollogarinë e bankës Gjermane

Katrina: "Ajo e bankës e ka raportuar nënën. Ajo kinse kishte dyshim se prej nga ajo i kishte marë 10.000 euro... kur ia ka pa asaj 10.000 euro të gjithat nga 20 euro banknota ajo e ka thirrur policinë."

- **7.8.2009 në orën 22:34:14**

X. pranon një SMS nga një numër i Gjermanisë

"Hej dajë, nëna po thot se situata nuk është e mirë. Hyr online, ta gjemë një zgjidhje."

Oficeri hetues, Rreshteri Gashi, shpjegon se personat e përfshirë në aktivitetet kriminale e përdorin internetin për të komunikuar në mënyrë që ti shmangen rrezikut të përgjimit të komunikimeve.

- **8.8.2009 në orën 19:01:24**

X. flet me një person mashkull të panjohur (UMP)

X.: "a të thash se ai njeri do të vjen, kjo është punë e kryer... dhe sa lypi ai për sasinë?"

UMP: "Ky tha 85."

- **12.8.2009 në orën 21:32:32**

X. i dërgon dy SMS të dashurës së tij

"Të Shtunën do të shkojë me Qerën në Shqipëri, duhet të bëjmë diçka atje."

"Jam i mërziur, e ky idioti nuk po përgjigjet në telefon. Nëse është vendosur të niset nesër, nuk e dijë çfarë të bëjë."

- **12.8.2009 në orën 21:33:27**

X. pranon një SMS nga e dashura e tij

“100 kg mish do të kryejnë punë (do të jenë të mjaftueshme).”

Të pandehurit kishin një mori komunikimesh lidhur me ngarkesën e Shtatorit, duke filluar nga 1 Shtatori 2009. Vetëm më 2 dhe 3 Shtator 2009 ishin 16 telefonata dhe mesazhe me SMS në mes të X. T.t dhe A. K. , me të cilat është bërë logjistika e ngarkesës së Shtatorit. Gjatë këtyre dy ditëve 25 telefonata dhe SMS-a në total janë dërguar në mes të anëtarëve të grupit kriminal. Në komunikime të ndryshme që i kanë paraprirë të ashtuquajturës ngarkesës së Shtatorit ka referime për dërgesën e drogave në Itali (“në ujë”) dhe në Zvicër (“tek kryqi”). Referimi tek Zvicra si kryq është referencë në flamurin e Zvicrës. Disa nga komunikimet janë referuar më poshtë:

- **1.9.2009 në orën 12:09:36**
Person i panjohur e thërret X. T.

X.: Po mendojë shumë shpejtë, deshta vetëm që të vijë së pari të të takojë dhe... pastaj ta vazhdojë procedurën. Deshta të nisem dje por nuk ka para.

- **1.9.2009 në orën 12:21:59**
X. T. e thërret A. K. n

X.: I ke çkyqur të dy telefonat.

A.: Po, sapa i kam ndezur ato.

X.: A je çmendur apo çka ke?

- **1.9.2009 në orën 21:54:09**
X. T. flet me S. T.

X.: Fola me atë dostin. Ai mundet të vijë nesër, ai mund të nisët... për të shkuar atje, tha se nuk ka problem. I duhet të shkojë tek uji, a po më kupton?... Ai më pyeti sa kushton makona e tij. I thashë se nuke dijë.

S.: Makina kushton 12.00 euro.

X.: 12.000 euro? Ai te udhëkryqi i don 1.700.

S.: Është gati kurdo që ai don.

X.: Mirë, po i them që të nisët dhe të vijë këtu, kur të mbërrijë këtu do ta bëjë një thirrje.

S.: Po ai niset, por ti duhet të afrohesh nesër afër Quekesit, afër Kukesit, do të takohemi atje. Duhet të takohemi nesër, gjatë ditës, duhet të takohemi atje.

X.: Kudo që ti dëshiron, vetëm ma bë një zile dhe unë do të shkojë atje.

- **2.9.2009 në orën 16:44:57**
X. e thërret të dashurën e tij, Valentinën

Valentina: Ku gjindesh tani?

X.: Jam gati afër doganës.

Valentina: Vërtetë, me Qerën?

X.: Me Qerën. Gati afër doganës.

- **2.9.2009 në orën 16:48:50**
X. e thërret Gezim Gjiken

X.: Hej dajë, jam duke ardhur drejt teje me dostin tem, ne jemi bashkë.

- **2.9.2009 në orën 19:44:08**
A. K. e thërret X.n

X.: Jam në mes të Tiranës, ku kam me qenë, ku je ti?

A.: Unë jam në Prizren, vetëm sa erdha.

X.: Jam me këtë shokun, kur do të vjen ai djali?

A. : Nesër.

X.: Në çfarë kohe, pas dite apo në mëngjez?

A. : Ai po vjen, kjo është me rëndësi.

- **2.9.2009 në orën 20:18:49**
A. K. i dërgon SMS korierit

“Ka shku me e marrë. Sapo të kthehet do të të thërras.”

Grupi fillimisht e kishte planifikuar që ti sjellte drogat në shtëpinë e X. T.t në Caprac dhe nga aty, ta dërgonte në Zvicër dhe gjetiu. Më 2 Shtator 2009 X. e thirri A. dhe i tha “kur ata të vijnë tek unë, menjëherë ne duhet ta kryejmë atë sepse ajo nuk duhet qëndruar tek unë.”

Më 3 Shtator 2009, X. e informon A. se korieri do të hyjë në Kosovë të nesërmen ("nesër daja është këtu"). X. dhe A. janë parë duke u takuar me njëri tjetrin nga ana e njësimit të vështrimit të Policisë së Kosovës në orën 18:58 në mbrëmjen e 3 Shtatorit 2009 tek Restorani OK afër Prizrenit. Pas kësaj ata shkuan te Restorani Dora ku ata biseduan deri në orën 22:00. Menjëherë më pas, njësiti i vështrimit ka vërejtur se X. T. ka shkuar te Restorani Estrada në fshatin Malësi e Re, ku ai takoi një numër të madh njerëzish, përfshirë një person me një makinë Golf me regjistrim Silloven LJ 38 SF dhe një tjetër me makinë BMW me regjistrim të Zvicrës LU 237 324

Më 4 Shtator, X. ka marrë një SMS nga S. T. që e ka informuar atë se korieri do të jetë tek vendi i X.s "rreth orës 8". Në orën 21:01:42 të asaj nate, S. T. e ka thirrur X. T. për ti thënë atij se "majmuni është atje", fjala e koduar për korierin. T. premtoi se do ta dërgoi me mesazh numrin e korierit dhe në orën 21:03:12, T. i dërgon X.s një SMS me numrin e telefonit "44715171". Ky është numri i telefonit i G. I. t, korierit.

Pas marrjes së numrit, X. e thërret dy herë G. I. n dhe e udhëzon G. që ta pres X.n në sallën e martesave afër kompleksit të Hotelit Albes në fshatin Korishë, afër Prizrenit. X. ia përsërit udhëzimet e tij G. që ta pres "sepse njëri nga njerëzit e mijë po vjen tek ti (te) pompa e benzinës." Njësiti i vështrimit të Policisë së Kosovës e ka vërejtur takimin e X. T. me dy persona të cilët dolën nga një furgon VW të gjelbërt që mbante regjistrim të Kukësit KU 1962 tek kompleksi Albes rreth orës 21:13. Tkimi zgjati deri rreth orës 21:28, kur shoferi i furgonit u largua në drejtim të kufirit të Shqipërisë. Shoferi i furgonit, G. I. , ndaloi në pompën e benzinës Badallaj afër kufirit. Ai e parkoi furgonin, i hapi dyert e garazhit, dhe e futi makinën brenda. Njësiti i vështrimit nuk kishte mundësi të shoh se çfarë ndodhi brenda në garazh.

G. I. ka qëndruar brenda në garazh deri në orën 21:41, kur ai doli dhe ngau makinën drejt kufirit përmes Vermices. Prokuroria argumenton se kjo është dëshmi e hollësishme se I. i ka lënë drogatat në garazh prej nga ai i morri ato të nesërmen për dorëzim.

Në mëngjesin e 5 Shtatorit 2009, X. T. dhe A. K. u takuan në Restorantin Albes mes orës 09:19 dhe 09:50. Në orën 09:16, X. ka marrë një mesazh SMS nga një numër i Shqipërisë që kishte të bënte me destinimin e drogave, "Murghentahl, afër Arau." Murghentahl gjendet në Zvicër. Pas takimit, X. u largua në drejtim të Prishtinës dhe A. mbeti në zonën e Prizrenit.

G. I. është kthyer në Kosovë mëngjesin e 5 Shtatorit 2009. Ai po voziste te njëjtin kombi me të cilin është parë ditën e mëparshme, me tabela të Shqipërisë KU 1962. Oficeri i vëzhgimit e ka përshkruar personin e vetëm që gjendej në kombi si vozites, "në moshe afërsisht 50 vjeç, me floke të verdha, veshur me bluze të bardhe, xhinse në ngjyre blu dhe kepuce të zeza." Ky përshkrim përputhet me karakteristikat fizike të G. I. t. I. ka vozitur kombin tek i njëjti garazh në Badallaj në të cilin ai kishte hyrë ditën e mëparshme. Ai ka hyrë në garazh dhe ka mbyllur dyert, dhe në këtë mënyrë ua ka

bere te pamundur skuadres se vezhgimit pamjen e aktiviteteve te tij. Kombi ka mbetur brenda garazhit deri ne oren 09:51.

Ne oren 09:59, kombi ka shkuar tek nje dyqan ne fshatin Korishe (fshati i A. K.) dhe nje person tjeter ka dale nga vetura Golf III me ngjyre blu te erret, me tabela te Kosoves 438-KS-121, i cili eshte bere vozitesi i kombit. I. ka dale nga kombi dhe ka mbetur ne kembe. Kombi eshte vozitur nga vozitesi i ri deri ne fshatin Caparc, fshatin e X. T.t.

Ne fshatin Caparc, vozitesi i ri i ka zevendesuar tabelat e kombit, ka hequr tabelat e Shqiperise dhe i ka zevendesuar ato me tabela te perkohshme Gjermane. Pastaj kombi nga nderruar drejtim. Besohet se vozitesi i kombit e ka kuptuar se po e vezhgonte nje skuader vezhgimi dhe se vozitesi e ka hedhur drogen ne nje fushe aty afer, me qellimin qe ajo te merrej perseri me vone.

Ne oren 10:11, kombi eshte shfaqur perseri ne autostrade dhe ka vozitur ne drejtim te kufirit me Shqiperine. Kombin e kane ndalur dhe kontrolluar, por brenda automjetit nuk eshte gjetur droge.

Ne oren 10:34 X. ka thirrur S.in per problemet gjate dergeses se droges. X. tha, "Dikush tjeter i ka takuar ...une kam telash te madh, djemte e mi, sepse njerezit kane shkuar pas tyre. Per ate zot, tani ... ai po thote se ata arriten te iknin, e kupton? Kur e pane se po i ndiqnin, kane nderruar drejtim." X. ka raportuar tek S. , "Per ate Zot, ata iken, eshte bere telash i madh, ata kane vozitur perpara tyre me vetura; e gjithë kjo eshte telash i madh."

X. i tha S.it se ai po shkonte te shikonte se si ishte situata. Ai i tha Sylejmanit se "femra" (kod per drogen) eshte lene ne rruge ne nje vend te sigurt. X. e ka gjetur ate cka ishte hedhur nga kombi dhe me vone raporton se "gjithcka eshte ne rregull." Pastaj ai i tha A.t te bleje numra te IPKO-s, ne perpjekje per te shmangur pergjimin e komunikimeve.

Ne daten 11.09.2009, H. T. ka thirrur X.n nga nje numer Hollandez dhe i ka thene, "...e ka kryer punen dhe domethene se fitimi eshte 86.000."

Kolegji, kur ka kthyer aktgjykimet si jo fajtores per dergesen e pretenduar te Shtatorit 2009, ka aplikuar ate qe kupton me 'barren e provave' ne lende penale, qe domethene prove pertej cdo dyshimi te aresyeshem. Per shkak te natyres se vazhdueshme te hetimit, policia ka zgjedhur qe te mos perpiqet te gjeje pakon qe po transportohej ne daten 5 Shtator. Kolegji nuk e kritikon policine per sjelljen e tyre ne daten 5 Shtator dhe e kupton se ngjarjet e dites kane ndodhur ne kontekstin e nje hetimi te vazhdueshem shume-kombetar. Por fakti qendron se substancat kontrolluara te pretenduara nuk jane konfiskuar dhe telefonatat e pergjuara nuk jane mjaftueshmerisht te qarta per te percaktuar natyren e substances. Si rezultat, kolegji

nuk mund te hamendesojë për atë çka gjendej në pako dhe që pretendohet se po transportohej.

Prokuroria nuk ka arritur të provojë elementet e akuzave 1 dhe 2 përtej dyshimit të arsyeshëm dhe si rezultat, të pandehurit lirohen nga akuzat e blerjes, posedimit, shpërndarjes dhe shitjes së paautorizuar të drogës së rrezikshme narkotike, që pretendohet të ketë ndodhur në Shtator 2009. Për më tepër, prokuroria nuk ka provuar elementet e akuzës 5, Krim i Organizuar, kundër G. I. t, dhe ai lirohet nga kjo akuzë.

Pas ngjarjeve të Shtatorit, X. T., A. K. dhe të tjerët kanë vazhduar të marrin pjesë në grupin e krimit të organizuar. Roli i X. T. ishte të organizonte, mbikqyrte dhe drejtonte aktivitetet e grupit të organizuar kriminal duke planifikuar dhe koordinuar importimin, dërgesën dhe financimin e dërgesave të substancave të kontrolluara. A. K. ka marrë pjesë aktive në grupin e organizuar kriminal, mes të tjerash, duke u marrë me korrieret për të transportuar substancat e kontrolluara, duke e ditur se pjesëmarrja e tij do të kontribuonte në kryerjen e krimeve të renda nga grupi.

Duke filluar nga Tetori 2009, X. T. ka organizuar, mbikqyrur dhe drejtuar blerjen e 109 kilogram cannabis sativa nga ortake në Shqipëri. T. ka planifikuar transportin nga Shqipëria në Kosovë për shpërndarjen e planifikuar në dhe shitjen në destinacione të tjera Evropiane. Megjithatë, droga nuk ka arritur në Kosovë apo në destinacionin e planifikuar në Evropë. Por, në 25 Nëntor 2009 Policia e Shqipërisë ka përgjuar një veturë Benz Mercedes me tabelë të Shqipërisë TR75981, e cila ishte e braktisur nga korrieret kur këta kanë parë skuadrën e përgjimit të Policisë së Shqipërisë. Vetura mbante 102 pako cannabis sativa, me një peshë totale prej 109 kilogramesh. Paketat i ka analizuar Laboratori i Forensikës dhe Kriminalistikës i Shqipërisë, i cili konfirmoi përmbajtjen e tyre si cannabis sativa.

Në datën 04.10.2009, H. T., anëtar i grupit të organizuar kriminal, i cili jeton në Hollandë, e ka thirrur X.n dhe i ka thënë, "Një shok imi me pozite ka ardhur nga Zvicra. Ka ardhur një djale shumë i mire, që ka para." Menjëherë me pas, X. ka bërë plane që të shkojë në Shqipëri për të bërë marreveshje me G. G. për dërgesën tjetër (shikoni komunikimet e përgjuara të datës 07.10.2009 mes X.s dhe H. T.).

Pas pesë ditësh, A. Trolli ka thirrur X.n nga Holanda. A. e pyet X.n nëse ky i ka parë "paketat" dhe e pyet nëse janë të vogla apo të mëdha. X. përgjigjet "ka nga të gjitha llojet, i dashur. Dhe më vjen keq që nuk kisha një kamerë për t'u bërë një fotografi gjithë atyre veturave...kishte nga të gjitha edhe pse une nuk marr vesh shumë nga vetura, por dukej të ishte dicka shumë e mire." Duhet shënuar se fjale 'vetura' është kod për pako të drogës së jashtëligjshme. X. e ka udhëzuar A.in që ta thërrasë në numrin e tij të IPKO-s.

Në datën 26.10.2009, X. ka thirrur A. K. . X. ka raportuar se kishte ngrënë drekë me shoqe nga Vermica dhe kur A. e pyet, "Çfarë të thanë?" X. i përgjigjet, "Çfarë mutin

kane me thene? Ata thane se do te te japin aq para sa te duash”, te ciles A. i pergjigjet, “Kjo eshte me e rendesishmja.”

Ne daten 17 Nentor 2009 X. i dergon G. G. nje mesazh SMS ku thuhet “Do jete gati per te Enjten, 100 deri ne 150 metra katrore.” Te nesermen, X. ka derguar nje mesazh vijues ku thuhej “kam biseduar me ate burrin qe eshte komandant; me siguri qe puna do te kryhet, 100 deri ne 150 metra katrore.”

Ne daten 19 Nentor 2009, X. T. u takua me G. G. prane nje pazari ne Prizren. Takimin e ka vezhguar skuadra vezhguese e policise se Kosoves. Ata te dy jane pare tek takoheshin tek nje restorant, “Marlboro” ne Prevalla, prej nga ata shkuan se bashku tek nje restorant tjetër, ne shtepine e vellait te X.s, dhe prej aty tek restoranti i X.s, ‘Dora’. Ne te njejten dite, G. e ka pyetur X.n, “Nje shoku im po me lutet per nje pune; mund te me besh nje nder per ate gomar?” X. i pergjigje “Do te te jap pergjigje pas 2-3 oresh”, te cilit G. i pergjigjet “Per rreth 15 ose 20 mije.” Termi ‘gomar’ perdoret nga dilerat e droges qe te pershkruaje nje korrier.

Ne daten 21 Nentor 2009, H. T. thirru X.n qe ta informonte se “te henen do te marrim 110.000 euro qe duhet ti dergohen G. per mallin e tyre” dhe se ai i kishte marre 62.200. X. i ka kerkuar Hamdiut ti dergonte ketij 1000 euro nepermjet Western Unionit. Po te njejten dite, A. T. e ka thirru X.n dhe e ka pyetur per cilesine e droges. A.i tha, “Vendi duhet te jete i paster ... plehrat duhet te jene te pastra.” X. i tha A.it te mos e vrase mendjen per kete.

Gjate dy diteve te mevonshme, ka patur biseda mes X.s dhe A. T.it persa i perket financimit te marreveshjes dhe ndarjes se fitimit. Ne daten 24 Nentor 2009, G. G. i dergoi nje mesazh SMS nje ortaku me numrin 0685381239 ku thuhej “do te arrijme neser ne mengjes”, qe domethene se dergesa per ne Kosove ishte planifikuar te mberrinte te nesermen, me 25 Nentor 2009.

Ne daten 25 Nentor 2009, policia Shqiptare e ka vezhguar G. G.en dhe pese persona te tjere tek takoheshin ne qytetin e Fierit ne Hotel ‘Europa’. Burrat kane arritur ne tre vetura te ndryshme, njera prej te cilave ishte Benzi Mercedes me tabela TR7598. Burrat me vone u larguan nga hoteli me vetura dhe mbajten nje distance prej 2-3 km ne mes te veturave te ndryshme. Sic eshte thene me lart, benzi Mercedes eshte gjetur i braktisur nga personat qe ishin brenda. Ne te gjendeshin 109 kilograme cannabis sativa.

Pas arrestimit te X. T.t dhe A. K., Policia e Kosoves ka kryer bastisjet e shtepive te tyre. Gjate bastisjes se vendbanimit te X. T.t eshte konfiskuar nje arme e paligjshme. Gjate njerës prej telefonatave te pergjuara, X. ka pyetur se ku mund te bleje nje veture te blinduar.

Policia ka gjetur 13.000 Euro gjate bastisjes se vendbanimit te A. K.. A. K. nuk ka burim te ligjshem te ardhurash dhe shpjegimi i tij per patjen e nje shume kaq te madhe

te hollash ne banesen e tij thjesht ishte i pabesueshem. I vetmi shpjegim logjik per te hollat e gjetura ne banesen e A. K. eshte se kjo perfaqeson pjesen e tij te fitimit te grupit te organizuar kriminal.

Prokuroria ka provuar pertej cdo dyshimi te aresyeshem se X. T. eshte fajtor per akuzen 3, Blerje, Posedim, Shperndarje dhe Shitje te Paautorizuar te droges narkotike te rrezikshme (dergesa e muajit Nentor) dhe denohet per kete krim, sic eshte pershkruar ne dispozitiv te ketij akt-gjykimi. Per me teper, Prokuroria gjithashtu ka provuar pertej cdo dyshimi te aresyeshem se X. T. dhe A. K. jane fajtores per akuzen 4, Krim i Organizuar dhe jane denuar per kete krim, si ne dispoziv.

Me qellim qe te caktohet denimi, kolegji ka marre parasysh rrethanat renduese te meposhtme:

- Kohen e zgjatur gjate se ciles te pandehurit jane perfshire ne aktivitetin e krimit te organizuar;
- Rendesine e krimit te kryer nga te pandehurit;
- Fitimin e madh te marre nga secili i pandehur ne lidhje me aktivitetet e tyre te paligjshme; dhe
- Demin qe i eshte shkaktuar komunitetit dhe anetareve te publikut nga importimi i droges narkotike te rrezikshme.

Gjykata nuk ka gjetur asnje rrethane lehtesuese qe te merren ne konsiderate ne favor te asnjorit te pandehur. Gjykata ka marre ne konsiderate funksionin e denimit ne kete lende: te pengoje te pandehurit nga kryerja e aktiviteteteve te ngjashme ne te ardhmen dhe te fenoje te tjeret nga pjesemarrja ne keto lloj aktivitetesh te organizuara kriminale.

Gjykata eshte e bindur se denimi i dhene eshte ne perpjesetim me rendesine e krimit.

Kryetarja e Trupit Gjykues
Karen Asphaug

Anëtare e Trupit Gjykues
Fillanza Kadiu

Anëtarë i Trupit Gjykues
Ferdinando Buatier de Mongeot

Procesverbal Mbajtese
Svetoslava Savova

Keshille Ligjore: Palet kane te drejten te parashtrojne ankese kunder ketij akt-gjykimi brenda pesembedhjete (15) ditesh pasi kopja e akt-gjykimit tu jete derguar, ne perputhje me Nenin 398, Paragrafi 1 i Kodit te Procedures Penale te Kosoves (KPPK) ne Gjykaten Supreme te Kosoves nepermjet Gjykates se Qarkut te Prishtines. Ankesa duhet te lajmerohet brenda tete ditesh nga data e akt-gjykimit.